



MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

NDËRMJET

AGJENCISË SË KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

DHE

KOMUNËS SË GJAKOVËS

Për zbatimin e Pilot Projektit

“Promovimi i Eficiencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë”

PRISHTINË, 2021

NENI 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të sigurohet bashkëpunimi i dakorduar dhe i ngushtë midis palëve nënshkruese në implementimin e pilot projektit “Promovimi i Eficiencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë”, duke përdorë sistemin eficient të ndriçimit.

NENI 2

Baza ligjore

Ky projekt është në pajtim të plotë me zbatimin e Planit Nacional për Eficiencë të Energjisë, dhe është vazhdim i bashkëpunimit në fushën e promovimit të eficiencës në mes të Ministrisë dhe Komunave të Kosovës e që kontribuon në përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE).

NENI 3

Përgjëgsitë e Palëve

1. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të kontribuoj si në vijim:

- 1.1 Menaxhimi dhe koordinimi i përgjithshëm i projektit, duke përfshi organizimin e takimeve për progresin e projektit dhe konsultimet e nevojshme;
- 1.2 Ofrimi i përkrahjes financiare në vlerë prej € 277,200.00 (dyqind e shtatdhjet e shtatë mijë, e dyqind Euro) ndaj Komunës së Gjakovës nga këto dy kode 15372 Programi i zbatimit të masave të EE dhe 18364 Zbatimi i masave të EE dhe BRE në Qendrën për Ekselenc Digjitale në ITP – Prizren, pagës e cila do të përmbyllet brenda tri viteve ndaj Komunës;
- 1.3 Prezantimi i rezultateve tek njësia kërkuuese dhe agjencitë tjera qeveritare, si dhe tek akterët tjerë;
- 1.4 Mbikëqyrja e progresit të projektit;

2. Komuna e Gjakovës do të kontribuoj si në vijim:

- 2.1 Menaxhimi dhe koordinimi i projektit,
- 2.2. Bashkë-financimi i projektit në shumën prej € 118,800.00 (njëqind e tetëmdhjetmije e tetëqind Euro) në periudhën trevjeçare.

3. Prezantimi i rezultateve të projektit në Kolegjiumin e Drejtorëve të Shërbimeve Publike, Asociacionin e Komunave të Kosovës si dhe ministritë përkatëse e akterët tjerë,
4. Përpilimin i raportit përfundimtar brenda dy javëve pas përfundimit të projektit.

NENI 4

Menaxhimi dhe Mbikqyrja e Projektit

1. Palët nënshkruese pajtohen që të emërojnë një Menaxher të kontratës për mbikëqyrjen e implementimit të projektit, sa i përket transparencës dhe kualitetit të punimeve, në përputhje me dokumentacionin dhe brenda kornizës buxhetore.
2. AKEE do të jetë përgjegjës për procedurat e prokurimit, menaxhimin e tenderit dhe kontratës sipas Ligjit të Prokurimit Publik të aplikueshëm, përfshirë nënshkrimin e kontratës me ofertuesin e suksesshëm.
3. AKEE dhe Komuna e Gjakovës do të pajtohen për procedurat e pagesave për palën e kontraktuar për kryerjen e punimeve si dhe atë të mbikëqyrjes bazuar në kushtet e kontratës.
4. AKEE dhe Komuna e Gjakovës pajtohen të zhvillojnë një plan zbatues Brenda një jave pas nënshkrimit të MeM.
5. AKEE dhe Komuna e Gjakovës do të komunikojnë rregullisht me njëra tjetrën për të koordinuar aktivitetet që lidhen me këtë marrëveshje.
6. Palët e nënshkruara sigurojnë që personat të cilët janë të angazhuar në përgatitjen dhe implementimin e masave të specifikuara në Marrëveshjen e Mirkuptimit dhe nënshkrimin e kontratës për furnizim dhe shërbime të cilat do të financohen, nuk do të kërkojnë, pranojnë, apo të marrin premtim për pagesë të ndonjë shume ilegale apo ndonjë përfitim të llojit tjetër në lidhje me këto detyra.

NENI 5

Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të Marrëveshjes.

NENI 6

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Z. Arsim Kutliqi

Kryeshef Ekzekutiv



Prishtinë, më 20/01/2021

Komuna e Gjakovës

Z. Ardian Gjini

Kryetar i Komunës



Prishtinë, më 8/2/2021